

Interview To
Emirjeta Adhami
(Chief of Environment Department Academy of
Science Hydrometerological Institute)

P: Cila eshte pervoja juaj ne realizimin e programit te monitorimit te cilesise se ujrale siperfaqesore ne kuader te programit te mbrojtjes se mjedisit?

P: Ne baze te ligjeve ne fuqi Instituti Hidrometeorologjik ka per detyre te zbatoje programin e monitorimit te mjedisit ne disa parametra kryesore hidrometeorologjik dhe te cilesise se ajrit dhe ujit . Nje nga keto detyra eshte edhe realizimi i programit te monitorimit te cilesise se ujrale siperfaqesore ne Republiken e Shqiperise, detyre qe kryhet ne bashkepunim me Ministrine e Mjedisit. Per kete Instituti ka ngritur nje rrjet monitorimi ne lumenj, liqene dhe bregdet. Ne kete program jane percaktuar edhe parametrat kryesore dhe indikativ te ndotjes se ujrale si dhe frekuencia e kampionimit duke patur parasysh qe te marrin nje informacion te besueshem e te vlefshem per institucionet lokale dhe qendrore.Ky informacion vlen per te vleresuar gjendjen e ujrale siperfaqesore ne vendin tone ne menyre qe te merren masa per shmangien e burimeve ndotese ose minimizimin e ndoteseve ne keto mjedise ujore. Per realizimin e nje programi sa me te efekshem duhet nje permiresim i teknologjive te kampionimit dhe analizes analitike, ngritura e nje rrjeti me stacione automatike me transmetim on-line si dhe nje bashkepunim me i mire midis institucioneve persegjegjese per monitorimin e mjedisit.